

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**


**Për Programin e Studimit Master Profesional në “Siguria dhe Rendi Publik”**

**Ofruar nga Kolegji Universitar “Luarasi”**

Eksperti i vlerësimit të jashtëm

Prof. Dr. Kristaq Xharo

Dr. Marjana Çadri



Janar 2019

Faqe 1 nga 55

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Per Programin e Studimit Master Profesional ne "Siguria dhe Rendi Publik"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Luarasi"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 511, datë 16.10.2017
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik"
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik/ 2 semestra
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017 - 2018
16	Numri i Studentëve	16



## HYRJE

Programi Studimit "Master Profesional" në "Sigurine dhe Rendin Publik" është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018 bazuar në Urdherin Nr. 511 date 16.10.2017 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për hapjen e programeve të reja të studimit për ciklin e dytë të "Master Profesional" në "Sigurine dhe Rendin Publik" pranë Kolegjit Universitar "Luarasi. Ky program studimi është me kohë të plotë, me 60 kredite dhe kohe zgjatje 1 vit akademik.

Mbi bazën ligjore të urdherit të mesiperm në KU "Luarasi" u bë hapja e programit të ri të studimit "Master Profesional" në "Sigurine dhe Rendin Publik" i cili ofrohet nga Departamenti i të Drejtës Penale, në kuadrin e Fakultetit të Drejtësisë.

Programi i mesiperm përben risi në teresinë e programeve bashkëkohore në fushën e drejtësisë dhe konsiston në një studim të kombinuar të teorive dhe praktikave të sotme në fushën e rendit dhe të sigurisë publike me synimin që studentët në përfundim të masterit të zotërojnë kapacitetet e nevojshme teoriko profesionale, në përfundim të detyrave funksionale në fushën e sigurisë dhe të rendit publik.

Në këtë program studimi janë regjistruar për herë të parë 16 studentë, të cilët vijnë nga rendit dhe e sigurisë. Të gjithë studentët që ndiqnin këtë program studimi ashtu sikurse na u konfirmua edhe gjatë vizitës dy ditore në institucion ishin të punësuar dhe ky master i kishte ndihmuar ata për të thelluar më shumë njohuritë në fushën e Sigurisë dhe të Rendit Publik.

## GRUPI I VLERESIMIT TE JASHEM (GVJ)

**Përbërja e GVJ:** Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Kristaq Xharo dhe Dr. Marjana Cadri ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 21.12.2018 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 15.01.2019 Institucioni, me shkresë Nr. 9 Prot., kthen përgjigje në formë zyrtare, në të cilën shprehet se nuk ka komente për të.

Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## 1. Misioni/Objektivat e programit te studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik” eshte hartuar dhe zbatuar ne perputhje me objektivat dhe misionin e KU “Luarasi” per pergatitjen e specialisteve te larte, te pajisur me dije bashkekohore per sigurine dhe rendin publik per te kontribuar ne sektoret e rendit publik dhe intiligjences ne permbushje te nevojave te tregut te punes dhe nivelit te sotem te luftes kunder kriminalitetit dhe korrupsionit.

Ky program eshte mbeshtetur ne kapacitetet qe zoteron KU “Luarasi,” ne pervojen e fituar ne fushen e arsimit dhe pergatitjes se specialisteve me kualifikim teoriko profesional.

Niveli i larte i mesimdhënies dhe praktikave profesionale, programeve dhe teksteve me nivel bashkekohor realizohet nga nje staf specialistesh, eksperte te afirmuar ne fushen e sigurisë dhe të rendit publik.

Objektivat akademike dhe shkencore te ketij programi studimi jane të mirëpërcaktuara sipas strukturave përgjegjëse të këtij institucioni.

Programi i Studimit “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik” mundeson studimin e kombinuar te teorive me te perparuara ne fushen e sigurise dhe rendit publik, si dhe zbatimin e tyre ne praktike, duke siguruar nje arsimim te nivelit te larte profesional te studenteve, me dije bashkekohore per sigurine dhe rendin publik si dhe me njohuri te qendrushme ne fusha te peraferta e duke ndikuar keshtu ne zhvillimin e kapaciteteve operuese e drejtuese te strukturave ku ata jane te angazhuar. Gjithashtu programi synon projektimin dhe perdorimin me efektivitet te aftesive te fituara ne kete program, si nje vlere e shtuar, brenda strukturave te perfshira ne luften kunder krimit ne pergjithesi dhe atij te organizuar ne vecanti.

### Vleresimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimeve ne “Master Profesional” ne “Sigurine dhe Rendin Publik” eshte hartuar ne perputhje te plote me stategjite, misionin dhe detyrat e KU “Luarasi”, duke synuar pergatitjen e larte teoriko-praktike te specialisteve ne fushat sigurise publike . Programi i studimit, eshte hartuar duke marre parasysh kerkesat dhe nevojat e tregut te punes per specialiste te profilit te sigurise kombetare, ne kushtet e sotme te ballafaqimit me nje dinamike te larte te krimit te organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit ne plan kombetar e rajonal. Ky program është hartuar duke marre ne konsiderate strategjite dhe linjat e zhvillimeve ekonomike e sociale te vendit ne kushtet e sotme por edhe te perspektives se zhvillimit ekonomik. Programi Master Profesional në Siguria dhe Rendi Publik, gjykuar nga objektivat qe synojne te realizojne, strukturen qe paraqet, permbajtjen qe
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

	shtjellon dhe metodat qe aplikon pasqyronë arritjet me te mira ne kete fushë si dhe promovon vlerat me te shendosha te tradites dhe te kultures kombetare.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi “Master Profesional” në Siguria dhe Rendi Publik është hartuar ne baze te nje metodologjie rigoroze shkencore ne perputhje me “Strategjine e zhvillimit institucional per vitet 2017-2020” te miratuar nga instancat vendimmarrese te tij. Ne konsultim me strategjine konstatuam hapjen e profileve te reja ne fushen e drejtesise, per pergatitjen e specialisteve ne profile te kerkuara nga tregu i punes.
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;  <b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Programi Master Profesional në Siguria dhe Rendi Publik eshte hartuar ne perputhje me ligjislacionin ne fuqi Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me aktet nenligjore qe rregullojne veprimtarine e institucionit. Emertimi i Programit te studimit “Master Profesional” ne “Sigurine dhe Rendin Publik” eshte hartuar ne perputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve te pershtateshme per kete cikël studimesh.
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	KU “Luarasi”disponon te miratuar Planin Strategjik te Zhvillimit institucional per periudhen 2017-2020 i cili parashikon si permiresime cilesore te programit te studimit ne mesimdhëni dhe te nxënit ashtu dhe ne proceset e teknologjike. Ajo cka doli ne pah edhe nga takimet e realizuar ne KU “Luarasi” eshte se Institucioni ndërmer vazhdimisht iniciativa për përmirësimin dhe vlerësimin e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Strategjia e përmirësimit të mësimdhënies synon përfshirjen e studentit në diskutim aktiv të rasteve, etj.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>Nga sa me siper konstatojme se KU “Luarasi” veprimtarine e vet si ne nivel institucional ashtu edhe ne nivel departamentesh apo programe studimi e zhvillon te mbeshtetur ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi .</p> <p>Programi i Studimit “Master Profesional” ne “Sigurine dhe Rendin Publik” eshte hartuar, duke mbajtur parasysh linjat themelore te misionit dhe qellimeve per te cilat funksionon institucioni.</p> <p>Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Programi perkon me nevojat e tregut te punes per pergatitjen e specialisteve te larte ne specialitete qe plotesojne kerkesat e sektoreve te sigurise dhe te rendit publik.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit pergjegjes per programin e studimit)

### Pjesa pershkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura akademike e Fakultetit te Drejtesise, pergjegjes per progamin "Master Profesional" ne "Siguria dhe Rendi Publik" eshte e strukturuar sipas Ligjit nr.80/2015. Ai perbehet nga 3 njesi baze te cilat jane Departamenti i se Drejtes Publike, Departamenti i se Drejtes Private dhe Departamenti i se Drejtes Penale i cili eshte departamenti pergjegjes per programin e studimit objekt i ketij vleresimi.

Departamenti eshte njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit. Departamenti ka për detyrë të nxisë, organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij.

Konstatohet se përbërja e Departamenteve është:

1. **Departamenti i Departamenti i se Drejtes Publike** ka në përberje të tij **7 pedagogë efektiv (PAE)**, nga të cilët: 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore "Doktor" dhe 4 pedagogë kanë diplomë Master i Shkencave; si edhe 7 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 1 pedagog me titull Prof. Dr., 3 pedagogë me gradën shkencore "Doktor", 1 pedagog në proces doktorature, 2 pedagog me diplomë Master i Shkencave.
2. **Departamenti i se Drejtes Penale** ka në përberje të tij **7 pedagogë efektiv (PAE)**, nga të cilët: 1 pedagog me titull Prof. As. Dr., 4 pedagogë me gradën shkencore "Doktor", 2 pedagogë me diplomë Master i Shkencave; si edhe 9 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 8 pedagogë me me gradën shkencore "Doktor" dhe 1 pedagog me diplomë Master.
3. **Departamenti i se Drejtes Private** ka në përberje të tij **8 pedagogë efektiv (PAE)**, nga të cilët: 2 pedagog me titull Prof. As. Dr., 2 pedagogë me gradën shkencore "Doktor", 4 pedagogë me diplomë Master i Shkencave; si edhe 4 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 1 me titull Docent, 2 me gradën shkencore "Doktor", 1 pedagog me diplomë Master i Shkencave.

Autoriteti drejtues i njësisë kryesore është Dekani i cili mban titullin akademik Prof. As. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore.

Përgjegjësi i Departamentit i cili ka gradën shkencore Doktor eshte dhe pergjegjes i njesise baze.

### Vleresimi i Treguesve te matshem:

- Struktura akademike e Fakultetit** ( Shih tabelen ne Aneks)

Struktura akademike e Fakultetit te Drejtesise, eshte ne perputhje me ligjin e arsimit te larte. Ai eshte i perbere nga 3 njesi baze.

Nga analiza e treguesve te paraqitur ne Raportin e Vleresimit te Brendshem (RBV) dhe gjendja e konstatuar nga ana jone , rezulton se per vitin akademik 2017-2018 nuk ka patur asnje ndryshim ne strukturen organizative te Fakultetit te Drejtesise te parashikuar ne Statutin e KU "Luarasit" dhe ne Urdherin Nr.188, date 15.05.2015, te Ministrin te Arsimit dhe Sportit "Per riorganizimin e njesive kryesore te institucionit te arsimit te larte "Shkolla e Larte Private "Luarasi" pasi programi ka funksionuar per vetem nje cikël studimor.



Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet e realizuar në Institucion rezulton që për vitin akademik 2017-2018, secila nga njësitë bazë ka në përbërje të saj 7 anëtarë efektive në përputhje me ligjin 80/2015, 3 prej të cilëve mbajnë gradën shkencore Doktor i shkencave.

**☑ Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabelat në aneks)**

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL (RVB) dhe takimeve që patëm në institucion, rezulton se për vitin akademik 2017-2018 Fakulteti i Drejtësisë ka aktualisht në përbërjen e tij, 40 anëtarë, 22 prej të cilëve janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 18 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK).

Njesia përgjegjëse për programin master ka një strukturë komplete të stafit akademik mesimdhënes, me pedagoge efektive dhe pedagoge me kohe të pjesshme, që përmbush standartet e kerkuara të gradave dhe titujve shkencore, të rekrutuar mbi bazën e konkurimit dhe vjetërsisë në punë dhe të kontributeve mesimore dhe shkencore në disiplinat e këtij programi. Secili nga Departamentet përgjegjës të këtij fakulteti ka në përbërje të tij 7 anëtarë efektivë. Departamenti i së Drejtës Penale i cili është përgjegjës për këtë program studimi ka në përbërje të tij në total 16 anëtarë nga të cilët 7 PAE dhe 9 PAK.

Njesia përgjegjëse për programin master ka një strukturë komplete të stafit akademik mesimdhënes, me pedagoge efektive dhe pedagoge me kohe të pjesshme, që përmbush standartet e kerkuara të gradave dhe titujve shkencore, të rekrutuar mbi bazën e konkurimit dhe vjetërsisë në punë dhe të kontributeve mesimore dhe shkencore në disiplinat e këtij programi

Personeli Administrativ (PA) është në funksion të të gjithë universitetit dhe përbëhet nga 13 anëtarë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Institucioni ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, dhe mbi bazën e akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>KU "Luarasi" ofron programe studimi në deget drejtesi, ekonomisë, teknologji informacioni dhe inovacion dhe ka si synim themelor të qenit një institucion mesimor shkencor që përgatit specialiste me profil të lartë teoriko praktik në fushat respektive.</p> <p>KU "Luarasi" ofron programe studimore që iu përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe standarteve të larta në përgatitjen e specialisteve nga këto fusha.</p> <p>Bazuar në urdherin nr.188 dt 15.05 .2015 të Ministrit të Arsimit dhe të Sportit, KU "Luarasi" ka qënë i organizuar në dy njësi kryesore:</p> <p>1.Fakulteti Ekonomik 2.Fakulteti i Drejtësisë</p> <p>Së fundmi me Urdher 266, datë 14.05.2018 KU "Luarasi" ka hapur edhe njësinë e tretë kryesore që është Fakultetit i "Teknologjise se Informacionit dhe Inovacionit".</p>

	<p>Fakulteti i Drejtesise perbehet nga tre njësi baze të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i te Drejtes Penale.</li> <li>2. Departamenti i te Drejtes Private.</li> <li>3. Departamenti i te Drejtes Publike.</li> </ol> <p>Ky master ofrohet nga Departamentin e Drejtes Penale te Fakultetit te Drejtesise dhe i cili ka ne perberjen te tij 7 (shtate) anëtarë me kohe te plote, 3 prej te cileve gezojne tituj e grada shkencore Dr. dhe 1(nje) me titullin Prof. Asoc. Dr., si dhe 9 pedagoge me kohe të pjesshmë, nga të cilët 8 Dr dhe 1Msc.</p>
<p><b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Ky fakultet si njesia baze, ne permbushje te detyrave ligjore, konform Statutit dhe Regullores te institucionit realizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Rekrutimin e stafit akademik per programet e studimit që ofron;</li> <li>-Mbikqyr ecurine e programit të studimit;</li> <li>-Mbikqyr ecurin e planit mesimor dhe cilesine e realizimit te tij;</li> </ul> <p>Rekrutimi i stafit akademik, sic konstatuam,nga analiza e dokumtacionit, kontakti i drejtperdrejte me instanca pergjegjese si departamenti, dekanati, rektorati, por edhe verifikimi i disa praktikave te konkurimit dhe emerimit te stafit akademik realizohet me procedura te konkurimit te hapur me transparence, objektivitete dhe paanshmeri.</p> <p>Kriteret qe duhet te plotesojne kandidatet per personel akademik, per vendet e lira te punes propozohen nga pergjegjesi i departametit perkates (pas nje konsultimi me anetaret e departamentit) në baze të nevojave që ka.</p> <p>Dekani pasi verifikon propozimin e departamentit ia percjell Rektorit per miratim. Nga ana e tij, Rektori, nxjerr urdherin e brendshem per ngritjen e komisionit per orgnizimin e procedures per shqyrtimin e aplikimeve.</p> <p>Pas shqyrtimit te dosjeve te aplikanteve komisioni, me procesverbal i paraqet Rektorit kandidatet me te kualifikuar.</p> <p>Rektori, nga ana e vet, i propozon Administratorit emerimin e personelit akademik.</p> <p>Admistratori i KU "Luarasi" nenshkruan kontratat e punes me personelin akademik.</p> <p>Vendet vakante shpallen në faqën Eëb të IAL.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vleresimit:</u></b></p>	
<p>Nga të dhënat e paraqitura nga IAL në dosjen e vetëvlerësimit si edhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion konkludua se, organizimi i strukturave të KU "Luarasi" është në përputhje me Ligjin 80/2015.</p>	



Tre njësitë përbërëse të Fakulteti të drejtësisë janë të organizuara dhe funksionojnë komform legjislacionit në fuqi.

Departamenti i te Drejtes Penale, përgjegjes për programin e studimit MP në Siguria dhe Rendi publik ka në ka ne perberje të tij 7 pedagoge PAE, 4 prej tyre kane graden shkencore Dr. dhe 1(nje) Prof.As. dhe 2(dy) me Msc.si dhe 9 PAK prej të cilëve 8 me graden shkencore Dr. dhe 1 (nje) Msc.

Procedura e rekrutimit dhe e emerimit te stafit akademik ne Fakultetin e Drejtesise realizohet ne perputhje me dispozitat e Statutit, Rregullores, me nje proces konkurues i cili angazhon si njesine integrale, fakultetin, ashtu dhe njesine bazë.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Në informacione vënë ne dispozicion nga institucioni për këtë program studimi pasqyrohen te dhenat të plota per kualifikimin e personelit akademik efektiv, personel akademik me kontrate, te dhena per personelin administrative ndihmes si dhe te dhenat per shperndarjen e ngarkeses mesimore,per raportet personel - admimnistrativ dhe student etj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni dhe gjatë vizitës se kryer konstatuam se në IAL rezulton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur akademik për realizimin e ketij programi studimi. Në këtë program studimi janë të angazhuar 11 pedagoge prej të cilëve 4 PAE dhe 7 PAK. I gjithë stafi akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi ka një karriere te gjatë akademik dhe janë nga figurat të shquara në fushën e Sigurisë dhe Rendit Publik.

GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion dhe në takimet e realizura konstaton se 43% e ngarkesës mësimore mbulohet nga staf akademik efektiv dhe 57% nga staf akademik me kohë të pjesshme. Ashtu sikurse na u konfirmua edhe gjatë takimeve me titullarët e Institucioni ka qënë e vështirë që ky program studimin të mbulojë në pjesën më madhe të tij nga staf PAE bazuar në specifikën e tij. Ky program ka vetëm një vit akademik që është aktivizuar.

Në takimet në KU "Luarasi" me dekanen e fakultetit dhe shefin e departamentit, u informuam se IAL është duke bërë përpjekje që për vitin e ardhshëm akademik 2018-2019 të rekrutojë e stafit akademik efektiv, cili të mbulojë ngarkesën mësimore deri në masën 70%.

Vlen të theksojmë se është e vështirë të gjes specialist të mirë duke patur parasysh edhe specifikën e kësaj fushe, të cilët jo vetëm duhet të jenë specializuar në këtë fushë, por të kenë edhe kualifikimin e duhur me grada e tituj akademik.

Pavarësisht vështirësive konstatuam se institucioni, por në vecanti departamenti janë kujdesur të rekrutojnë staf sa më të kualifikuar për realizimin e një programi sa më cilësor dhe konkurues në treg.

Marrëdhënia e punës midis të punësuarit dhe Institucionit rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur në Kodin e Punës, dhe në zbatim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Për vitin 2017 – 2018 nisur nga kerkesat e departamenteve për personel akademik janë kryer në mënyrë transparente te gjitha procedurat e nevojshme për rekrutimin e personelit akademik .

Nga verifikimi i dokumentacionit te vene në dispozicion nga Zyra e Burimeve Njerzore gjatë vizitës në IAL konstatuam se pranë kësaj zyre ka të dhëna të plota për secilin nga anëtarët e stafit akademik .

**Vleresimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,dhe të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelën 4 në Aneksi) (Tabelat në Aneks)

GVJ konstaton se se te dhenat e raportuara nga Institucioni në lidhje me stafin akademik dhe kualifikimin e tij, te pasqyruara ne Raportin e Vleresimit te Brendshem jane te njejta me ato të verifikuara gjatë vizitës në vend.

Në këtë program studimi janë të angazhuar 11 pedagogë prej të cilëve 4 PAE dhe 7 PAK. Stafit akademik efektiv mbulon 43% të ngarkesës mësimore kurse ai me kohë të pjesshme 57%. Në përbërje të stafit PAE janë: 1 Prof. As dhe 3 Dr, ndërsa stafi PAK ka në përbërje të tij 6 Dr. dhe 1 Msc.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IAL dhe nga vizita në vend konstatojmë se ngarkesa e personelit akademik përbëhet prej 3 komponentësh: a) mësimdhënie; b) punë kërkimore shkencore; c) punë në mbështetje të institucionit (kjo vlen për stafin PAE). Ngarkesa në orë mësimore e stafit PAE varion nga 235 deri në 180 orë, kurse stafi akademik PAK ka një ngarkesë të ulët që varion nga 72 deri në 16 orë mësimore.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit**

Nuk disponojmë të dhëna për këshillin e profesorëve.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre ( Tabela në Aneks)**

Sic kemi theksuar edhe më sipër në këtë program janë angazhuar 11 pedagogë. Ka një raport të mirë midis personelit akademik me tituj dhe atyre me grada: 1 me titullin Prof. As, 9 kanë gradën doktor shkencash/PhD dhe 1 doktorant. Duke gjykuar mbi profilin e pedagogëve, lëndët që ata mbulojnë i përkasin formimit të tyre/fushës së tyre të ekspertizës duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në cilësinë e këtij programi studimi.

- Të dhënat sipas seksit dhe moshës së personelit (Tabelat në Aneks)**

Nga të dhënat që disponojmë nga dokumentacioni i vetëvlerësimit si edhe të dhënave të verifikuara gjatë vizitës në vend, rezulton se aktualisht në Programin e studimit MP në Siguria dhe Rendi Publik janë angazhuar 2 pedagoge femra dhe 9 meshkuj.

PAE përbëhet nga 3 grup moshë: 1 është në grup moshën 25-35 vjec, 1 është në grupmoshën 36-45 vjec dhe 1 në grupmoshën 66-68 vjec.Ndërsa për sa i përketë PAK përbëhet nga disa grupmosha: 1 është në grup moshën 25-35 vjec, 1 është në grupmoshën 36-45 vjec, 1 është në grupmoshën 46-55 vjec, 3 janë në grupmoshën 56-65 dhe 1 në grupmoshën 66-68 vjec.

Përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin më të mirë të stafit me përvojë me stafin e ri dhe është një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e njësisë.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Konstatuam se kontratat individuale te punes per secilin pedagog efektiv dhe me kontate pune jane te depozituara prane zyres se burimeve njerzore ne baze te Statutit dhe te Rregullores se funksionimit te institucionit. Stafit akademik, mbeshtetes dhe administrativ njihen me detyrat dhe pergjegjesite, te drejtat dhe detyrimet qe kane ne perputhje me pozicionet e punes.

Kontratat e punes jane hartuar konform Kodit te Punes se RSH dhe percaktojne te drejtat dhe detyrimet e paleve ne respekt edhe te ligjit nr 80/2015 dhe ne akteve normative per shperblimin, ngarkesen mesimore, dhe lirine akademike. Në kontratat e punës të vëna në dispozicion nga KU “Luarasi” evidentohen koha e fillimit të marrëdhënies të punës, kohëzgjatja e kontratës së punës, përshkrimi i punës, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, orët e punës, zgjidhja e kontratës së punës. Kontrata shoqërohej me anekse përkatëse ku parashikohen detyrat administrative, vlerësimi i punës, raporti për punën shkencore dhe detyrimet funksionale për stafin akademik.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë (Tabelat në aneks)**

Rezulton se personeli ndihmes administrativ ne KU “Luarasi” eshte i punesuar me kohe te plote. 15 persona jane ne dispozicion te fakultetit te Drejtesise si personel mbeshtetes per kryerjen e detyrave sipas pershkrimit te vendit te punes. Personeli ka kualifikimin e nevojshem.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Standardi/Kriteret
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Ne zbatim te statutit dhe te rregullores se funksionimit te institucionit, personeli akademik, ndihmes mesimor-shkencor, dhe administrativ i perfshire ne realizimin e programit te studimit “Master Profesional ne Sigurine dhe Rendin Publik”, ishte i angazhuar ne veprimtarite mesimore, kerkimore - shkencore, sherbime per zhvillimin e institucionit, ne konsultime e keshillim me studentet, dhe detyra te tjera me karakter administrativ te percaktuara ne kontratat individuale te punes</p> <p>Sic konstatuam nga nje shqyrtim i kujdeshem i materialeve ne dispozicon, secili nga pedagoget e lendeve ishte i angazhuar ne realizimin e detyrimeve qe burojne nga statusi dhe identiteti i tij profesional, te cilat ishin te normuara dhe kontrolluara nga ana e departamentit te Drejtes Penale, Njesise se Brendshme te Kontrollit te Cilesise.</p> <p>Ne kete kuader edhe personeli ndihmes mesimor-shkencor i cili asiston personelin akademik, i perzgjedhur edhe ky mbi bazen e kriterëve profesionale, jepte ndihmesen e vet ne realizimin e objektivave per nje pergatitje sa me profesionale te studenteve.</p> <p>Nje pjese e konsiderushme e personelit admistrativ ishte punesuar me kohe te plote ne kancelari, zyren e admistrates, finances sekretari, biblioteke, laboratore dhe sherbime te tjera.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	

**Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personeli akademik në Fakultetin e Drejtësisë sic na rezulton nga shqyrtimi i dokumentave në dispozicion, kontakti me titullarin, personat përgjegjës për drejtimin e njësive studimore, është i angazhuar në vijimesi për hartimin e kurrikulave, analizen dhe vlerësimin e tyre në procesin e mesimdhënieve dhe mesimnxenit.

E gjithë trupa akademike, mer pjesë në organet kolegjiale si Senati akademik, Këshilli i Fakultetit, Departamenti, dhe kontribuon në përbushjen e kompetencave në lidhje me hartimin e kurrikulave të programeve studimore dhe rritjen e cilësisë së tyre.

Në institucionin "Luarasi" rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga një shqyrtim i kujdesshëm i dokumentacionit dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në vend, konstatohet se janë realizuar procedura transparente për rekrutimin e stafit akademik.

Nevojat për staf akademik nisën nga departamenti, me pas dërgohen në dekanat, me tej në rektorat dhe ky i fundit pas miratimit ja dërgon këto kërkesë zyres së burimeve njëzore. Kjo zyre bën publikimin e vendve vakante dhe kriterëve për për zgjedhjen e kandidatëve. Pas dorëzimit të dosjes nga ana e aplikantëve bëhet një për zgjedhje paraprake bazuar në kriteret dhe me pas është një fazë e dytë, në të cilën ngrihet një grup Ad hoc për seleksionimin e stafit të ri.

Ngarkesa mësimore është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.

Gjatë vizitës në institucion u informuam se këto vitet akademik është zbatuar Udhëzimi 29 të MASR në lidhje me ngarkesën mësimore duke u kujdesur që ajo mos të kalonte 260 -300 ore.

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion konstatohet se, ngarkesa në orë mësimore e stafit PAE varion nga 235 deri në 180 orë, kurse stafi akademik PAK ka një ngarkesë të ulët që varion nga 72 deri në 16 orë mësimore. Kjo ngarkesë e lejon stafin akademik që të merret edhe me punë kërkimore shkencore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në kualifikimin e tij të mëtejshme edhe për marrjen e titujve dhe gradave

**Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik realizohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Në rastin konkret, për rekrutimin e personelit të ri, në programin Master profesional në Siguria dhe Rendi Publik ish-in zbatuar me korrektesë proceduar e miratura tashme që garantojnë një proces të hapur e transparent.</p> <p>Në këtë program studimi janë të angazhuar 11 pedagogë 4 PAE dhe 7 PAK. GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga IAL dhe të dhënat e marra gjatë vizitës në vend konstaton se, 43% e ngarkesës mësimore mbulohet nga staf akademik efektiv dhe 57% nga staf akademik me kohë të pjesshme. Ashtu sikurse e kemi theksuar dhe më lart është e vështirë të gjendet staf akademik të kualifikuar në këtë fushë bazuar në specificitetin e saj. Ajo çka na u tha edhe gjatë takimeve është se IAL ka bërë dhe bën përpjekje të vazhduara për rekrutimin e stafit akademik sa më të kualifikuar.</p> <p>Në këtë institucion në bazë të rregullores funksionon Njësia e brendshme të Sigurimit të Cilesisë, si një organizim i ngarkuar me detyrën e kontrollit të cilesisë, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj mbi bazën e një plani tematik vjetor.</p> <p>Në bazë të planit tematik, njësia kishte planifikuar organizimin dy herë në vit aplikimin e pyetësoreve adresuar studentëve të programit për vlerësimin e punës së pedagogut në bazë të disa indikatorëve objektive.</p> <p>Në përfundim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit dhe dekani bëjnë vlerësim të arritjeve të pedagogëve në përmbushjen e detyrave funksionale të tij.</p> <p>Keto vlerësime si nga studentët ashtu dhe titullarët të njësive i behen të njohura pedagogut dhe depozitohen në dosjen personale.</p> <p>Dokumentacioni për pedagogët siç rezultoi nga kontakti tone me zyren e burimeve njerezore të KU "Luarasit" ishte i plotë dhe përmbante dokumentat të ndryshëm si CV, diploma, certifikata, kontratën individuale të punës me anekset e veta, etj.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit MP në Siguria dhe Rendi Publik, ka gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Të gjithë titullarët e lendeve janë me gradën Doktor të cilët janë specialiste me kontribute të vecanta në fushat respektive. Disa prej tyre janë autore tekstesh universitare dhe monografish shkencore të cilat ofrojnë një ekspertizë të lartë në çështjet që mbulojnë modulet e programit</p> <p>Në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 në këtë institucion janë të punësuar me kohë të plote Rectori</p>

<p>në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>dhe zv rektori, dekani i Fakultetit të Drejtësisë si dhe përgjegjësit e departamenteve perkatese. Institucioni ka arritur të sigurojë personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale duke respektuar standartin 1 pedagog për 12 studente që kryejnë praktikën profesionale. Vlen të thejsojmë që të gjithë studentet që kanë ndjekur MP në Siguria dhe Rendi Publik janë të punësuar dhe e kanë pasur shumë të thjeshtë realizimin e praktikave profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkepunimi me institucione shtetërore dhe private për kryerjen e praktikave profesionale të studenteve. Këto praktika realizohen në përputhje me fushën e studimit..</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p><b>Programi studimit është master profesional</b></p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Pedagoget titullare të programit të studimit Master Profesional në “Siguria dhe Rendi Publik” janë specialiste të njohur në fushën e kërkimeve shkencore dhe ofrojnë ekspertizën e tyre në realizimin e këtij programi edhe përsa i përket udhëheqjes së temave shkencore.</p> <p>Pedagoget titullare të programit studimor, garantojnë cilësinë e duhur në udhëheqjen shkencore të studenteve pasi janë autorë të një serie monografish dhe studimesh shkencore në fushat e kriminalistikës, të drejtës penale, të sigurisë publike. Ata kanë një bibliografi të pasur artikujsh shkencore të botuar në revistat shkencore, pjesëmarrës në konferenca dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mesimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Ne kuadrin e realizimit të programit studimor, institucioni ka angazhuar personel ndihmes mesimor shkencor me kualifikim adekuat i cili punon në dy laboratore kryesor që mbeshtesin këtë program studimor:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Laboratori i kriminalistikës</li> <li>2. Laboratori i informatikës</li> </ol> <p>Te dy labororet ishin të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin sa më të mirë të orëve laboratorike. Laboratori i kriminalistikës drejtohet nga Prof. As.Dr. L. V. specialist në fushën e kriminalistikës. Staf i akademik se bashku me personelin ndihmes mesimor- shkencor dhe administrativ në baze të rregullores dhe statutit, janë të angazhuar në mënyrë optimale për realizimin e programit studimor. Te gjitha</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Percaktimi i ngarkesës mesimore të personelit akademik është kryer në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në takimet e realizuara me titullaret e Institucionit na u tha se për shpërndarjen e ngarkesës mesimote këtë vit akademik ishin bazuar tek Udhëzimi nr 29 të MASR, në rregulloren etj. Në kontratën individuale të punës të çdo pedagogu ishte shënuar edhe ngarkesa mesimore në orë që ai realizonte. Ngarkesa në orë mësimore e stafit PAE varion nga 235 deri në 180 orë</p> <p>Nga sa më mesiper, konstatojmë se mesimdhënia e normuar për personelin akademik, nuk e kalon normën e përcaktuar, pasi numri i programeve studimore që afrohen aktualisht ky institucion është i vogël, në raport me numrin e personelit akademik që dikton ligji. Personeli akademik angazhohet në veprimtaritë si më poshtë: mesimdhënie, kërkim shkencor, aktivitete në mbështetje të programit mesimor, praktika mesimore, udhëheqje të temave të diplomës, tutoriat për studentin, mbështetje për institucionin, punë administrative në funksion të programit studimor.</p> <p>Aktivitetet e mesiperme konvertohen në orë mesimore të cilat përbejnë ngarkesën e personelit akademik dhe atij ndihmes.</p> <p>Nga materialet e vëna në dispozicion nga ana e institucionit, konstatojmë se ngarkesa e trupës mesimore ishte në parametrat optimale çka siguron realizimin cilësor të programeve.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon dosje te plota te stafit akademik, me kohe te plote dhe kontrata pune. Dosjet se bashku me kontrata individuale te punes ndodhen ne zyren e burimeve njerzore Institucioni disponon nje liste te plote te stafit akademik dhe administrativ te miratuar nga Senati akademik. Verifikimi nga ana e GVJ e kesaj liste deshmon perputhjen e programeve te studimit me listen e personelit te punesuar ne kete institucion.</p> <p>Institucion per cdo vend vakant apo nevoja per personel alademik publikon kriteret ne faqen e vet te internetit. Konstatuam se rekrutimi i personelit akademik kryet me procedura te rregullta me transparence dhe objektivitet.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vleresimit:</u></b></p> <p>Në programin e studimit MP në “Siguria dhe Rendi Publik” janë të angazhaur personel akademik, me tituj dhe grada shkencore dhe kanë një përvojë të pasur në fushën e sigurimit.</p> <p>Stafi akademik merr pjesë në hartimin e politikave dhe të strategjise së zhvillimit perspektiv të institucionit, si edhe në hartimin e programeve studimore, përmirësimin e kurikules etj.</p> <p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik është transparente dhe konform të gjithë procedurave të përcaktuara nga Institucioni. Njoftimi për vendet vakante dhe kriteret e përzgjedhjes së stafit publikohen në faqen zyrtare të internetit të IAL.</p> <p>Nga personeli akademik efektiv mbulohen 43% të ngarkesës mësimore dhe 57% mbulohet nga staf akademik me kohë të pjesshme.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna të plota për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><b><u>Rekomandim:</u></b></p> <p><i>I rekomandohet Institucionit të bëjë përpjekje të mëtejshme për rekrutimin e stafit të ri akademik, për të siguruar mbulimin e ngarkesës mësimore deri në masën 70% nga stafi PAE, sic parashikohet në Ligjin 80/2015.</i></p>	

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Godina e Kolegji Universitar “Luarasi” është e pazicionuar në Rrugën e “Elbasanit”, nr. 59, H.1, Kodi Postar 1010, në Tiranë. Ajo ka një sipërfaqe prej 3787 m<sup>2</sup>, në të cilën janë të lokalizuara sallat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët, biblioteka, sekretaria mësimore, zyrat për personelin, dekanin dhe zv/dekanin.



Gjatë vizitës në KU “Luarasi” u vizituan disa nga ambientet kryesore në të cilat zhvillohej ky program studimi si: salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laborator i informatikës, laborator i Kriminalistikës, sektetarite mësimore, etj. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin komode, dhe të gjitha ishin të pajisura me tabela për të shkruar, projektor dhe kompjuter. Sallat kishin kushte të përshtatshme ndricimi dhe kondicionimi. Biblioteka KU “Luarasi”, kishte kapacite për rreth 20 studentësh, e pajisur me një tavolinë ovale të madhe dhe me karrike përreth saj, një kompjuter dhe printer. Orari i bibliotekës ishte nga ora 08:30 – 19:00, duke i dhënë kështu mundësi edhe studentëve të këtij masteri i cili zhvillohet mbasdite, të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm. Sipas informacionit që na u dha kishte edhe një sallë leximi, por që ishte duke u rikonstruktuar. Gjatë vizitës u informuam se institucioni u ofronte studentëve edhe bibliotekë on-line. IAL që prej vitit akademik 2015-2016 ka një marrveshje me Bibliotekën onile Questia. Godina ka një laborator (Kabineti i Informatikës), i pajisur me një projektor i cili ishte i pasur me kompjutera/laptope, 1 server dhe dy printera/fotokopje. Ky laborator shërben për të gjithë programet e studimit që ofron IAL, përfshirë edhe programin e Masterit Profesional “Siguria dhe Rendi Publik”. Një tjetër laborator që vizitua që është në shërbimi të tij programi studimi ishte Laboratori i Kriminalistikës, i cili ishte i pajisur me të gjitha mjetet e nevojme për zhvillimin sa më të mirë të lëndëve/moduleve të këtij programi. Zyra e sekretarisë mësimore në funksion të programit të Masterit Profesional “Siguria dhe Rendi Publik” ishte e pajisur me: tavolina, karrike, kompjutera, printera. Në të kryhen procedurat administrative, mbahen regjistrat mësimore, procesverbalet etj

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Mjediset për Programin e studimit (Tabela në Aneks)

• Salla për leksione	11
• Klasa për seminare	2
• Salla për aktivitete promovuese	5
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	-
• Laboratorë për lëndët	4
• Laboratorë informatike	1
• Salla interneti	1
• Salla për bibliotekë	3
• Mjedis për fotokopjime, librari etj	2
• Zyrë informacioni për studentët	7

#### Mjediset për stafin:

• Mjedise për Dekanin/ kancelarin	5
• Zyra për sekretarinë mësimore	2
• Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	5

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Standardi/Kriteret
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni prej dy vitesh zhvillon aktivitetin e tij një godinë të re, të cilën KU "Luarasi" do ta ketë të në përdorim për 20 vite.</p> <p>Objekti i mesiperm shërben me kushte dhe kapacitete optimale për zhvillimin e veprimtarive mesimore e tekniko-administrative të këtij institucioni.</p> <p>Konstatuam se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkepunimi me institucione shtetërore dhe private për kryerjen e praktikave profesionale për studentet e Masterit Profesional "Siguria dhe Rendi Publik".</p> <p>Orët e praktikës mësimore apo laboratorike zhvillohen në laboratorin e kriminalistikës dhe atë të informatikës.</p> <p>Ky program studimi ofrohet në një godinë të vetme.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga RVB-ja dhe vizita në institucion u pa se e KU "Luarasi" ofronte një bibliotekë efikase dhe me tekste bashkëkohore. Shumica e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit ishin në bibliotekë kurse literaturën shtese ata mund ta aksesonin në Bibliotekën online Questia.</p> <p>Stafi akademik dhe studentet kane ne dispozicion një Fondi i bibliotekës përmban një numër të madh titujsh botimesh shkencore, traktatesh, revistash periodike dhe vjen duke u pasuruar vazhdimisht në përbushje të kërkesave dhe nevojave për një informacion sa më bashkëkohor që pasqyron arritjet me të fundit në fushën e drejtësisë në plan kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve të "Masterit Profesional" në "Siguria dhe Rendi Publik" një numër titujsh tekstesh, monografish, revistash të cilat përmbajnë informacionin e duhur dhe për përgatitjen e punimeve me karakter shkencor dhe temave të diplomës.</p> <p>Në bibliotekë ofrohet për studentet e këtij masteri shërbimi falas i bibliotekave online dhe aksesit pjesor në librari elektronike.</p> <p>Biblioteka shërben me orare të përshtatshme (08:30-19:00) për studentet dhe pedagogët, dhe ka ambiente optimale të cilat sigurojnë kushte për studim .</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b>	

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Gjatë vizitës konstatuam se KU "Luarasi" zoteron një numër të mjaftueshëm mjedisesesh si salla leksionesh, seminare, laboratore, etj, për realizimin e programit Master Profesional.

KU "Luarasi" ofron infrastrukturë moderne mësimdhënieie, që përfshin pajisje elektronike dhe teknologjike, në shërbim të nevojave të personelit dhe të studentëve

Institucioni ushtron aktivitetin akademik në një godinë e cila plotëson normen e sipërfaqes shfrytëzuese, kushtet teknike për ushtrimin e aktivitetit. Për realizimin çilesor të programit konstatuam se janë vënë në dispozicion të mesimdhënies teknologji të reja.

Mjediset mesimore, auditore, salla leksionesh dhe seminaresh janë të pajisura me mjete të përshtatshme teknike si kompjutere videoprojektore, lidhje interneti, aparature fonike, sisteme ndricimi dhe ajrimi të përshtatshme.

Laboratori i kriminalistikës është funksional dhe i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e praktikave laboratorike.

Në funksion të zhvillimit çilesor të programit të studimit vihen në dispozicion Laboratori i informatikës dhe Klinika ligjore.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

KU "Luarasi" ka siguruar infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e programit të Studimit Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik".

Në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve janë mjedise moderne mesimore, laboratore, biblioteka të cilat janë të pajisura me teknologji të reja dhe aparaturat e cilat ofrojnë çilesi në mesimdhënie dhe në formimin profesional të studentëve.

Biblioteka e Institucionit ka shumicën e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit dhe literaturën shtesë studentët mund ta aksesojnë në Bibliotekën online Questia.

Laboratorët në funksion të këtij programi studimi janë të pajisura me mjete të përshtatshme për realizimin sa më cilësor të orëve laboratorike.

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Bazuar në RVJ dhe në takimet e realizuar në Kolegjin Universitar "Luarasi" konstatohet se ai për sa i takon financimit dhe burimeve financiare funksionin konform legjislacionit në fuqi. Ai është pjesë përbërëse e shoqërisë "Panorama Grup" sh.a. Menaxhimi financiar i universitetit bëhet dhe nga Zyra e Financës së Kolegjit Universitar "Luarasi" në bashkëpunim me zyrën e financës së shoqërisë "Panorama Grup" sh.a.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Institucioni financohet nga tarifat e studentëve, pagesat e studentëve për shërbimet administrative dhe nga burime të shoqërisë "Panorama Grup" për disbalancat

afatshkurtra të krijuara ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditohet cdo vit në mënyrë të rregullt nga një ekspert kontabël i autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqëive tragtare.

Për këtë program studimi burimet e financimit janë kryesisht tarifat e studentëve dhe zënë 98.89% për vitin 2017 dhe 98.05% për vitin 2018. Të ardhura të tjera janë në masën 1.11% për vitin 2017 dhe 1.95% për vitin 2018.

Në zërat shpenzime pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për paga. Institucioni nuk ka siguruar të ardhura nga grantet për kë PS.

Gjatë vitit akademik 2017-2018 të ardhurat mesatare për student kanë qenë 1000 euro, me të cilat kanë mbuluar shpenzimet për student që lidhen me koston e punës dhe kryesisht pagesën e pedagogëve. Pra, të ardhurat mesatare kanë mbuluar shpenzimet mesatare gjatë kësaj periudhe.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi**

Këto të dhëna janë paraqitura sipas Tabelës në Aneksë.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Kosto e studimit për student për vit akademik llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve paraqitet sipas RVB është llogaritur 1.071 Euro.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Ne institucion auditit behet nga nje ekspert i jashtem i cili kryen per cdo vit pasqyrimin e llogarive kontabel, ne librat financiare, plotesimin sipas standarteve te kontabilitetit, zbatimin e ligjit per shoqerite tregtare, analizen e riskut.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj</p> <p>Institucioni ka ne dispozicion raportin e auditit dhe nje kopje i vihjet ne sdispozicion te QKR.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Bazur në RVB konstatohet se për çdo vit kalendarik hartohen pasqyrat financiare në zbatim të standardeve të kontabilitetit dhe të ligjit për shoqëritë tregtare.</p> <p>Në pasqyrat financiare gjenden të detajuara llogaritë aktive dhe të detyrimeve, pasqyra analitike të kapitalit, pasqyra e aktiveve dhe amortizim për periudhën përkatëse. Raportet financiare gjenden në Zyrën e Financës të Kolegjit Universitar “Luarasi”.</p> <p>Sipas RVB gjendja financiare e institucionit paraqitet e qëndrueshme, me kapitale financiare të mjaftueshme për të garantuar ecurinë normale të programeve të studimit .</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni kryen veprimtarinë financiare në përputhje me Ligjin “Për shoqëritë tregtare” dhe aktet nën ligjore në fuqi.</p> <p>KU “Luarasi” dokumenton aktivitetin financiar nëpërmjet pasqyrave financiare vjetore dhe auditimit të jashtëm të përvitshëm të llogarive të tij, nga ekspertë kontabel të rregjistruar.</p> <p>Gjendja financiare e institucionit është në parametra optimale dhe mundëson përmirësimin e metejshëm të parametrave për rritje cilësore të mesimdhënisë dhe përmirësim të shërbimeve për studentet.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në RVB, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendimin e Senatit Akademik të KU “Luarasi” Nr. 12/4, datë 23.12.2016 dhe e ushtron aktivitetin e saj në bazë të neneve 14 dhe 15 të statutit të KU “Luarasi”. Sipas statutit të KU “Luarasi” dhe takimit me kryetarin dhe dy anëtarë të NJBCS, ajo është përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore dhe i raporton drejtëpërdrejtë rektorit. Sipas RVB, NJBSC ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të miratuar në Senatin Akademik. NJBSC ka hartuar “Planin strategjik të sigurimit, rritjes dhe përmirësimit të cilësisë” për një periudhë kohore 2016-2020, në të cilin parashikohen aktivitetet që do të realizohen nga kjo njësi, mënyra e evidentimit të tyre, periudha kohore dhe personi përgjegjës. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët tre janë pjestarë të stafit akademik me kohë të plotë, një ekspert i jashtëm dhe një student. Në takimin me përfaqësuesit e NJBSC, GVJ u takua me tre anëtarë të saj, përfshirë edhe kryetarin.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:
  - o Sa anketime kanë bërë me studentët – dy anketime në vit

- Sa studentë janë anketuar – të gjithë studentët janë ftuar, por pjesëmarrja ka qenë e ulët vecanërisht në semestrin e dytë, kur pyetsori është përgatitur on-line.
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë – Sipas RVB janë përpunuar të gjithë pyetsorët dhe nuk ka dalë ndonjë problem.
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm – Problemet janë konstatuar, por për shkak të afatit të shkurtër kohor, pasi është një program studimi që është akdktivizuar për hërë të parë në vitin akademik 2017-2018 nuk ka qenë e mundshme të evidentohen hapat e mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve.

Gjatë takimit me përfaqësues të NJBSC, GVJ u informua se realizohen dy anketine për cdo semester të vitit akademik. Semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018 është bërë edhe vlerësimi on-line nga studentët mbi cilësinë e lëndës dhe mësimdhënies nga pedagogu. Sipas takimit me NJBSC, meqënëse pjesëmarrja e studentëve në anketimin on-line ka qenë më e ulët se në anketimin e parë është vendosur që anketimi i studentëve në vazhdim të bëhet me pyetësor të bëhet në hard copy.

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e cila ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në arritjen e objektivave të përcaktuara. Statuti përcakton se Senati Akademik është organi përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion në përputhje me standartet shtetërore. Funksioni i NJBSC është i përcaktuar në mënyrë të detajuar në nenin 74 të Statutit të KU “Luarasit”.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Bazuar në RVB dhe në takimet e realizuar me përfaqësuesit e kësaj zyre, garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJBSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në cdo njësi të funksionimit akademik dhe administrativ të KU “Luarasit”. Ngritja e GVB pranë Fakulteteve, përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJBSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB e fakulteteve. Në takimin me NJBSC, u konstatua se monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë shkonte deri në nivel departamenti.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJBSC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e vetëvlerësimeve vitin akademik 2017-2018.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Theksoj se, ky program studimi ka vetëm një vit jetë dhe për shkak të kohës së shkurtër të përpunimit të të dhënave, nuk është paraqitur informacion mbi hapat e mëtejshëm për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithsesi sipas RVB, në të ardhmen NJBSC nëpërmjet GVB-ve do të realizojë ndëkjken sistematike të vazhdimësisë së programit duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Dokumenti Raporti i Analizës Vjetore (2017-2018) i programit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”.  
Dokumenti Nr. 7 – Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Ne strukturen e organizimit të KU “Luarasi” ushtron veprimtarinë e saj një njësi e perhershme, Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është pjesë e stuktues se organizimit të KU” Luarasi” e ushtron veprimtarinë e saj si njësi e perhershme dhe ka për detyrë të vlerësojë ecurinë e programeve të studimit nepermjet instrumentave mates dhe vlerësues të cilat janë:</p> <p>Sondazhet e studenteve që ndjekin programet studimore dhe kryen në mbarim të ciklit të studimit nepermjet pyetsoreve në të cilat kërkojnë nga studentet opinionet e tyre për cilësinë e mesimdhënies, cilësinë e programeve, teksteve, etj.</p> <p>Pyetsore për studentet të cilat plotësohen në fund të semestrave dhe japin informacion për aftësitë profesionale të pedagogëve cilësinë e komunikimit me auditore, përdorimin e metodave të reja në mesimdhënie dhe praktika mesimore.</p> <p>Intervista me kampione studentesh ose fokusgrupe për secilin program studimi. Ky kampion zgjidhet në mënyrë rastësore nga anëtarët e njesisë, me qëllim grumbullimin e një informacioni sa më objektiv.</p> <p>Sondazhe të studenteve të cilët kanë përfunduar programin e studimit. Nepermjet këtyre sondazheve me studentet “alumni” njesia arrin të mbledhë një informacionin e nevojshëm mbi nivelin e arritur në përgatitjen e specialisteve për fushat përkatëse të cilët tashmë janë ballafaquar me kërkesat të vendit të punës</p> <p>NJBSC, përpunon të dhënat e grumbulluara, i dhe stafit akademik rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion në mënyrë konfidenciale.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit NJBSC përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta:</p> <p><b>Të tërthorta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, lëndëve/kurrikulës, dhe të të mësuarit</li> </ul> <p><b>Të drejtpërdrejta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dëgjime në auditor të cilat realizohen nga</li> </ul>

	<p>shefi i departamentit dhe nje anetar i NJSCB</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatet e arritura nga studentët bazuar në provimet e vlerësuara me nota ose pikë;</li> <li>• Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e ndërmjetëmë dhe përfundimtare.</li> </ul> <p>Bazuar ne kete metodologji, Njesia e brendshme e sigurimit te cilesise ka arritur ne perfundimin se: Programet studimore te cilat ofrohen nga institucioni KU "Luarasi" jane te mire orientuara ndaj kerkesave dhe nevojave te tregut te punes .</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi në faqen e internetit te KU "Luarasi", rezulton se ky i fundit publikon rezultatet e vleresimit dhe objektivat qe synon te arrije ne rritjen e nivelit te performances. Gjithashtu behet publik edhe raporti vjetor qe dergohet ne MARS</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecuresisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>KU "Luarasi" ben analizen vjetore per vleresimin e studimeve te ciklit te dyte dhe me konkretisht edhe per programin "Master Profesional" ne "Sigurine dhe Rendin Publik"</p> <p>Per permiresimin e programeve te studimit te ciklit te dyte dhe te programeve te integruara KU "Luarasi harton politika qe synojne realizimin e ketij objektivi.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia,</p>	<p>Per here te pare ne nivel institucional SHLUJ eshte akredituar me urdherin e Ministrit te Arsimit dhe Shkences, nr. 71 dt 18.02.2008. Ne vitin 2017 KU "Luarasi" është akredituar nga Agjencia britanike QAA në bashkepunim me ASCAL. Vlefshmeria e akreditimit institucional eshte 6 vite akademike.</p> <p>Institucioni "Luarasi" per realizimin e objektivit per pergatitjen e studenteve me cilesi te larte ne te tre hallkat e sistemit universitar, perdor instrumentat e kerkuara per sigurimin e cilesise.</p> <p>Ky funksion primar realizohet i perqendruar kryesisht nga nje strukture e mireorganizuar dhe operative sic eshte NJBSC e cila ne punen e saj perdor metoda per kontrollin e cilesise dhe mbikqyrjen e saj.</p> <p>Njesia e cilesise se bashku me njesite e tjera te institucionit ushtron kontroll te vazhdueshem per cilesine e mesimdhenies ne te gjithe komponentet e veprimtarise mesimore e shkencore.</p> <p>Kjo njesi ben vleresimin e programeve studimore duke u perqendruar kryesisht ne Syllabuset, me synimnin qe ato te mos interferojne me disiplina te tjera, por te ralizojne lidhje nderdisiplinore. Ne</p>



<p>politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>lidhje me perputhshmerine e literatures me programin, shikohet nese ka nivel shkencor te kohes, pershtatet me nivelin e dijeve dhe aftesive te studenteve. Ne rastet kur studentet kane stade te avancuara, kerkohej pasurimi i literatures me tituj te rinj me qellim qe te rriten aftesite dhe niveli i shkencor i dijeve te studenteve.</p> <p>Per rritjen e cilesise se formimit te studenteve, KU "Luarasi" ka lidhur marreveshje bashkepunimi me nje numur institucioneesh publike e private per zhvillimin e praktikave mesimore vecanerisht per aftesimin profesional te tyre.</p> <p>Senati i institucionit, mer ne analize praktika te testimi te cilesise se programeve te studimit te disiplinave te ndryshme, te veprimtarive me karakter mesimor-shkencor.</p> <p>Ne nivel departamenti diskutohen problematika qe kane te bejne me permiresimin e vazhdueshem te programeve tyre, me metodat dhe teknikat me te reja ne fushen e mesimdhenies.</p> <p>Njesia e Brendshme e Sigurimit te Cilesise te KU "Luarasi" ka hartuar dhe miratuar nje strategjie te posacme per permiresimin e cilesise.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Ku "Luarasi" realizon sigurimin dhe mbikqyrjen e cilesise ne perputhje me standartet e kerkuara nga, duke perdorur ne menyre te vazhdueshme instrumenta te matjes dhe te vleresimit si intervista, anketime, analiza te produkteve te veprimtarise se tyre si teza shkencore e punime shkencore.</p> <p>Njesise se Brendshme te Sigurimit te Cilesise ka krijuar mekanizmat e nevojshem institucionalë për të garantuar cilësinë. Konstatuam se kjo njesi eshte funksionale dhe mireingranuar ne kontrollin e mbikqyrjen e cilesise dhe kontribuon duke dhene sugjerime dhe rekomandime per Senatin Akademik.</p> <p>Kjo njesi ben vleresimin e programeve studimore duke u perqendruar kryesisht ne Syllabuset, me synimnin qe ato te mos interferojne me disiplina te tjera, por te realizojne lidhje nderdisiplinore.</p>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

#### Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Bazuar në dokumentacioni e paraqitur nga institucioni, programi i studimit Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik" në Kolegjin Universitar "Luarasi" është licensuar me urdhrin Nr. 511, datë 16.10.2017. Qëllimi dhe objektivat e programit janë ofruar në mënyrë të qartë. Ky program studimi ka si qëllim kryesor pajisjen e

studentëve me njohuri të thelluara në fushën e sigurisë dhe rendit publik, studimin e kombinuar të metodave dhe formave bashkëkohore të policimit e inteligjencës kriminale si dhe zbatim e tyre në sektorë të rëndësishëm të një shtet demokratik dhe jo vetëm për t'i shërbyer dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës në mënyrën më të mirë të mundshme.

Programi studimit MP në “Siguria dhe Rendi Publik” i ofron studentit njohuri të thelluara, e plotësuese mbi njohuritë e fituara në ciklin paraprirës të studimit, “Bachelor”, në fushën e së drejtës penale, apo edhe të njohurive të fituara nga programe studimi të fushave të ekonomisë, shkencave ekzakte, atyre të aplikuara, etj., dhe rritje të nivelit akademik, profesional, bazuar mbi kërkimin shkencor. Ky program studimi alternon pjesën teorike të thelluar me atë praktike. Programi përfshin lëndë të formimit bazë dhe lëndë të formimit specializues që lidhen drejtëpërdrejt me veprimtarinë praktike.

Aftësitë e fituara në këtë program studimi i përgatisin studentët për të vazhduar më tej punën në institucionet publike dhe ato private. Ata mund të punësohen si drejtues, specialistë apo këshilltarë në sektorin publik dhe privat.

Organizimi i programit është kryer konform rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi si persa i takon organizimit të programit në vite akademike, semestra, dhe kredite ashtu edhe persa i takon ngarkesës perkatese për çdo komponent. Programi i studimit është organizuar në bazë të krediteve ECTS sipas procesit të Bolonjës, për një total prej 60 ECTS, i cili realizohet në një vit akademike ose 30 javë mësimi në auditor, ose 15 javë për çdo semestër.

**Objektivat dhe qëllimet Programit Master Profesional në “Siguria dhe Rendi Publik” 60 kredite janë, student të fitoj:**

- kompetenca e njohuri të thelluara mbi organizimin, misionin dhe detyrat institucionale të strukturave të sektorit të sigurisë, sistemin normativ bazë që rregullon veprimtarinë e tyre;
- aftësi të plota menaxhuese e drejtuese për metodologjitë parandaluese në zgjidhjen e konflikteve dhe masat e veprimet ligjore e procedurale në rast ngjarjesh e situatash të veçanta për sigurinë dhe rendin;
- njohuri të thelluara dhe aftësi menaxhuese e drejtuese për shërbimet ekzekutive si të Policisë së Shtetit, shërbimeve të emergjencës, policive bashkiake, sistemit penitenciar, hetimit Page 54 tatimor e doganor etj.,
- dije të thella profesionale për ushtrimin me kompetencë të detyrave dhe attributeve të policisë gjyqësore në fushën e hetimit të krimeve dhe njohuri të plota teorike e praktike për mjetet e metodat shkencore dhe teknikat speciale investigative të autorizuara nga ligji procedural penal;
- njohjen e parimeve dhe taktikave të operimit të shërbimeve informative dhe mënyrat e marrjes e të trajtimit të informacionit kriminal, etj.;
- njohjen e metodave e të teknikave bashkëkohore në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve kriminale, të terrorizmit, etj.

**Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

Programi i studimit Master Profesional në “Siguria dhe Rendi Publik” është një program studimi me kohë të plotë i cili realizohet me 60 ECTS në përputhje me planin mësimor. Programi i studimit ka kohëzgjatjen një vit akademik, 2 semestra dhe 15 javë mësimore për çdo semestër në auditor. Provimet e lëndëve zhvillohen në fund të çdo semestri.

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor;
- 1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor;
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit;

- 1 orë mësimore ka 50 minuta;
- Programi zhvillohet nga e hëna në të premte;
- Studenti cdo ditë zhvillon jo më shumë se 5 orë mësimi.

**Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Programi i studimit është aktivizuar në vitin akademik 2017-2018. Në përfundim të këtij programi studimi do të pajisen me diplomë **Master Profesional në “Siguria dhe Rendi Publik”**.

Cdo lëndë ka një sasi orësh që ndahen në orë auditor dhe orë punë e pavarur që në total për të gjitha lëndët janë 1500 orë. Për vitin akademik 2017-2018 janë realizuar 360 orë leksione, 235 orë seminare në auditor, 30 orë praktika profesionale në auditor, 100 orë në auditor provimi përfundimtar (tema e diplomës), pra 595 orë në auditor dhe 905 orë punë e pavarur nga studenti.

Në planinin mësimor modulet janë vlerësuar me 4 dhe 5 ECTS.

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

▪ Për leksionet	10 orë në auditor dhe	15 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	5 orë në auditor dhe	20 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	8 orë në institucion dhe	17 orë punë e pavarur e studentit
▪ Prova Finale	5 orë në auditor dhe	25 orë punë e pavarur e studentit

Modulet në planin mësimor janë paraqitur edhe sipas veprimtarisë formuse (A-F) (Tabela në Aneks)

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) 6 ECTS
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) 30 ECTS
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme (C) 6 ECTS
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) 6 ECTS
- Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhë (E) 6 ECTS
- Teza e diplomës (F) 6 ECTS

**Ndryshimet në planin mesimor, krahasuar me programin mësimor të licensuar**

*Nuk ka ndryshime në planin mësimor pasi ka vëtëm një vit që është implementuar si program studimi*

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademikpërkatës**

Bazur në plani mësimor i lidhur me personelin akademik si edhe në CV e stafit akademik në këtë program krahas arsimimit, vërejmë se lëndët që ata mbulojnë janë në përuthje me fushen e tyre të ekspertizës. Stafit akademik i anafzhuar në programin e studimit MP në “Siguria dhe Rendi Publik” ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu mbartin edhe eksperiencë cilësore në detyrat që kanë kryer më parë ose vazhdojnë.

**Vlerësimi për Syllabus-et, dhe elementët e tyre për cdo lëndë**

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i lëndës /modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Titullari dhe emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit.
- Forma e vlerësimit të studentit
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Bazuar në RVB dhe informacioni i paraqitur nga Institucioni, përmban në përgjithësi të gjitha informacionet e kërkuara në pikat e mësipërme, duke respektuar emërtimet e lëndëve dhe tematikave të trajtuara.

**Analizë e cilësisë së Syllabuseve**

Në tërësi, silabuset janë të standardizuara dhe ofrojnë një panoramë të qartë të llojit të lëndëve, tipologjisë që u përket, kreditet, informacion për të kontaktuar pedagogun, një përmbledhje të shkurtër të lëndës, të vlefshme për të kuptuar në terma të përgjithshëm njohuritë që fitohen gjatë një semestri, konceptet themelore çelës, si dhe temat.

Silabuset paraqesin si domosdoshmërinë për t'ju përgjigjur kërkesave të çështjeve të sigurisë në periudhën aktuale e në perspektivë po ashtu ato kanë referencë institucione mjaft prestigjioze në perëndim. Silabuset vijnë me pretendimin për të mundësuar angazhimin në praktik të kandidatëve në strukturat respektive vendase por edhe me njohuri të nevojshme në bashkëpunimin me partnerët e huaj.

Syllabuset janë të ndara për dy grupe kresore lëndesh: për lëndët e kategorizuara në grupin e "Formimit të Përgjithshëm", si dhe për lëndët dhe modulet e kategorizuara në grupin e "Formimit Karakterizues". Grupi i lëndëve dhe modulet e kategorizuara në **kategorite** "A", "C", "D" dhe "E" që i përketin Formimit të Përgjithshëm, si grupi i disiplinave mësimore që i japin karakter të përgjithshëm Programit të Studimeve, në planin mësimor-akademik përbëhen nga rreth 7 lëndë (të cilat zënë rreth 46.6%) dhe kanë 28 kredite ECTS ose 43.3% të numrit total të krediteve.

Lëndët e Formimit Karakterizues ose profesional, pra ato të kategorizuara në grupin "B", si grupi i disiplinave mësimore që i japin karakter të përveçëm krejt programit të studimeve, në planin mësimor-akademik përbëhen nga 8 lëndë apo veprimtari dhe zënë rreth 53.3 % të numrit të përgjithshëm dhe kanë 34 kredite ECTS ose 56.6%.

Në sillabusin e cdo lende janë të pasqyruar të dhënat lidhur me përmbajtjen e lëndës, ngarkesën mësimore të saj (leksione, seminare, pune praktike, etj.), organizimin e veprimtarive formuese dhe kërkesat për përgatitjen e lëndës (frekuentim, punim relacionesh, esesh detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, praktika profesionale, përgatitje e temës së diplomës, etj), dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale të pritshme, literaturën e këshillueshme, si dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve

**Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Institucioni "Luarasi" ofron programe të akredituara në: "Bachelor ne Drejtesi" akredituar me Urdher nr.271 dt 29.06.2012 si "Bachelor" ne Drejtesi dhe "Master Profesional" ne "Specialist Jurist" ne Administraten Publike" te Shkolles se Larte Unversitare Jopublike

<p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>“Luarasi”, ne perfundim te se cilit studenti fiton 60 ETSC.</p> <p>Struktura e vitit akademik e KU “Luarasi” i garanton qe studenti me kohe te plote, ne perfundim te vitit akademik te siguroje 60 kredite.</p> <p>Persa me siper, institucioni per te plotesuar nevojat e tregut per profile te reja, duke mundesuar nje pergatitje me nivel te larte te studimeve “Master Profesional ne “Siguria dhe Rendi Publik”, eshte ne vijim te realizimit te objektiveve te ketij specialisteve ne sektorin e rendit publik.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i Studimit “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik” permban njohuri shkencore teorike dhe praktike, dhe synon te zhvilloje tek studentet aftesi e shprehi praktike ne specilitetet perkatese, te rendit dhe te sigurise publike.</p> <p>Programi eshte nje lidhje e ngushte me njohurite shkencore te lendeve qe permban programi Bachelor, dhe synon ne thellimin e metejshem te njohurive dhe vecanerisht te aftesive praktike, per te realizuar nje perqasje sa me optimale te studenteve me specifikat e specialiteteve te sigurise dhe te rendit publik.</p> <p>Konstatuam se te gjithë studentet qe frekuentuan masterin per vitin 2017-2018 vinin nga sektoret e sigurise dhe te rendit dhe gjate takimit pohuan se ky program u kishte mundesuar pajisjen me njohuri te nje standart me te larte dhe aftesi me te mira praktike ne ushtrimin e profesionit ku punojne.</p> <p>Programi “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik” ka arritur tu prezantoje studenteve standartet e sigurisë që përcaktohen në arenën ndërkombëtare si dhe teknikat dhe teknologjitë më të fundit që aplikohen.</p> <p>Programi permban lende te profilit te ngushte te sigurise dhe te rendit qe kane rritur aftesine profesionale te pervehtesueve te ketyre programeve .</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektiveve të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me</p>	<p>Konstatuam se objektivat e percaktuara ne dokumentatat e licensimit si program i ciklit te dyte jane arritur vecanerisht ne strukturimin e tij si nje program e specializuar profesional.</p> <p>Vleresimi i studenteve eshte bere me metoda te kombinuara ne vartesi te specifikave te lendes duke</p>

<p>anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>perdorur: Verifikim të dijeve në mënyrë permanente vleresime në seminare, detyra kurse, prezantime, punë kërkimore shkencore (paper research) etj.</p> <p>Verifikim permbylles i dijeve dhe shprehive të fituara me Provim me gojë, Provim me shkrim, Kazus, Teme diplome</p> <p>Perdorimi i një larmi metodash ka ndikuar për një vlerësim gjithëpërfshirës për një përgatitje teorike dhe praktike me të mirë të studentëve duke u mundësuar një pershtatje me të shpejtë në specialitetet e reja në sektorët e rendit dhe sigurisë kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Përvoja disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane kanë shërbyer si mbështetje për programet studimore dhe ka kombinuar në struktura dhe përmbajtje edhe arritjet me pozitive të vendit tonë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.</p> <p>Aplikimi i programit studimor është bërë pasi është konsultuar me grupe specialistësh standartet me të përparuar të BE dhe të disa vendeve anetare si Franca Italia, Gjermania etj.</p> <p>KU“Luarasi” ofron programe studimore të cilat sintetizojnë standarte ndërkombëtarisht duke i harmonizuar ato me specifikat e vendit tonë, traditën dhe përvojën me të mirë në këtë fushë.</p> <p>Në procesin e hartimit të dokumentacionit të “Masterit Profesional” është mbajtur parasysh që ai të përkojë me standartet e kerkuara nga BE, duke bërë harmonizimin e legjislativës tonë në fushën e drejtësisë e të arsimit të lartë me ato europiane.</p> <p>Në kushtet e bashkëpunimit me vendet partnere si dhe me ato të rajonit, programi ka synuar përfaqësimin e niveli të përgatitjes teoriko praktike të specialistëve në fushën e sigurisë dhe të rendit publik.</p> <p>Konstatohet se programi është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin e përputhje BE për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të</p>	<p>Programi Master Profesional në Siguri dhe Rëndësi Publikë ka objektiv aftësimin profesional të studentëve në kërkimin shkencor i cili realizohet në leksione dhe seminare nga pedagogët me shkallë të lartë kualifikimi.</p> <p>Për çdo lëndë të këtij programi është parashikuar prezantimi nga studentët i punimeve, dhe temave me karakter shkencor të cilat udhëhiqen me metodologjinë e kërkimit shkencor në drejtimin e pedagogëve.</p> <p>Programi i këtij masteri është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit perspektiv të institucionit dhe i ka</p>

<p>studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>te gjitha parametrat për të qene i aksesueshem për specialistet e sektoreve të sigurise dhe të rendit.</p> <p>Konstatuam se personeli akademik eshte i angazhuar ne veprimtarine shkencore si ne hartimin e teksteve mesimore, monografive shkencore, pjesemarjen ne konferenca e simpoziume, perfshirjen ne sisteme te avancuara te kualifikimit shkencor, marrjen e titujve dhe gradave shkencore etj.</p> <p>Veprimtaria kerkimore shkencore ne kete institucion zhvillohet sipas statutit dhe rregullores dhe tematika e kerkimit shkencor perkon me fushen qe mbulon departamenti.</p> <p>Rezultatet e humultimit i paraqiten Keshillit Shkencor apo dhe Senatit.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Ne procesin tone te punes per vleresimin dhe akreditimin e ketij programi studiuam materialin e pergatitur nga intitucioni per vleresimin dhe nevojat tregut dhe evidentojme se programi i studimit “Master Profesional” ne “Sigurine dhe Rendin Publik” është bashkekohor dhe i pergjigjet kerkesave te tregut te punes.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p>Sic cituam edhe me siper programi ka marre parasysh nevojat e tregut te punes per specialiste te fushave te rendit dhe sigurise, pergatitja e te cileve eshte bere mbi bazen e studimit dhe te aplikimit te standarteve europiane</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Para licensimit te programit, KU “Luarasi” ka hartuar nje studim analize per nevojat e tregut vendas i cili eshte miratuar nga organet vendimmarese te ketij institucioni. Studimi eshte kryer me synimin per te testuar mundesite e punesimit te studenteve ne tregun vendas, kerkesat e punedhenesve, nje parashikim te perafert te numurit te te regjistruarve etj.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p>	<p>Programi studimor i “Masterit Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik” eshte ne perputhje me Standartet e Cilesise te njohura nga Ministria e Arsmite dhe respekton traditat me te mira te vendit tone ne fushen e drejtesise .</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur</p>	<p><i>*Nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>

<p>në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Ky program realizohet me 60 kredite europiane ECTS per I vit akademike. Kreditet jane shperndare ne 12 lende dhe praktika mesimore qe zhvillohen rregullisht ne institucione shtetore dhe privat me cilat cilat KU “Luarasi” ka nenshkruar disa marveshje bashkepunimi. Provimi i diplomimit ose mbrojtja e tezës se diplomes ne mbarim te ciklit te programit kuotohet me 5 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p><i>*Nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Informacionet te detajuara per programet e studimeve, modulet e syllabuset lendore jane lehtesisht te aksesueshme per studentet- kandidate, te cilet mund te paraqesin kerkese ne sekretarine mesimore ose per te marre informacion te plote per planin mesimors i dhe per stafin akademik.</p> <p>Keto informacione gjenden te detajuara ne faqen zyrtare te ëeb. te KU“Luarasi”. Informacioni i njejte ofrohet edhe ne formatin e shkruar dhe elektronik te sekretarise mesimore</p>
<p><b>Standardi II.8 – Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani I diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master I Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>“Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik” i organizuar ne 2 semestra. Të gjitha lëndët në këtë program studimi janë semestrare dhe kanë kreditet përkatëse. Gjatë programit të studimit studenti i nënshtrohet një praktike mësimore ku ai vë në zbatim të gjitha njohurit e marra në këtë program. Në përfundim të programit, studenti përveç testimeve të njohurive në lëndët përkatëse zhvillon dhe një punë kërkimorë (temë diplome) nën udhëheqjen e pedagogut me titull dhe grade shkencore.Provimi /punimi i dipomes eshte kuotuar me 5 kredite.</p>
<p><b>Konkluzionet e vleresimit:</b></p>	
<p>Programet e studimit qe ofron KU“Luarasi” jane te licensuara dhe te akredituara dhe jane ne perputhje me qellimin dhe misionin kryesor diplomimin dhe kualifikimin e studenteve me njohuri, shprehi shkencore dhe praktike ne fushat e drejtesise , ekonomise dhe informatikes dhe inovacionit.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional” ne “Sigurine dhe Rendin Publik” eshte bashkekohor dhe hartuar ne perputhje me kërkesat e tregut te punës, legjislacioni dhe direktivat e BE. Ai i pergjigjet nevojave te tregut te punes per specialiste me kualifikim adekuat ne specialitetet respektive, te rendit dhe sigurise publike.</p> <p>Programi i studimi është i mirë strukturuar duke ndërthur aspektin teorik me atë praktikë.</p> <p>Syllabuset e lëndeve janë te plota dhe përmbjanë të gjithë informacionin e nevojshem. Literatur e perdorur në to është bashkëkohore.</p>	



## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Nga vëzhgimi vërehet se mësimdhënia në programin e studimit “Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik” realizohet nëpërmjet: leksioneve, projekteve dhe detyrave, praktikave, seminareve, dhe punimeve të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor. Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS) për 1 vit akademik. Këto kredite janë të shpërndara në 12 lëndë/disiplina si dhe në praktikën mësimore që zhvillohet në institucionet shtetërore dhe private dhe në institucione me të cilat KU “Luarasi” ka marrëveshje bashkëpunimi si dhe në provimin përfundimtar (Tema e diplomës) e cila mbrohet në përfundim të ciklit të studimeve ka 5 kredite.

Në takimet e realizuar në IAL na u bë me dije se kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet provimeve të cilat organizohen në formën e përcaktuar në syllabusin e lëndës. Provimet organizohen dhe kryhen nga komisionet e përcaktuara me vendim të dekanit të fakultetit në sezonet e përcaktuara në kalendarin akademik. Student kishte të drejtë të kontestonte rezultatet e provimit, kjo procedurë ishte e përcaktuar në rregulloren e institucionit.

Lidhur me provimet e ndërmjetme dhe format e verifikimit të dijeve, të parashikuara në syllabuset e programit, vlerësimi bëhet sipas një sistemi të përcaktuar nga pedagogu përkatës (pikë, nota) që i bëhen paraprakisht të njohura studentit.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies ka dy komponente: vlerësimin e programit dhe vlerësimin e pedagogut. Vlerësimi menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të KU “Luarasi”, nëpërmjet anketimeve, sondazheve, intervistave, etj., dhe në përfundim bëhet një analizë sasiore dhe cilësore e rezultateve, me qëllim evidentimin e problematikave dhe të fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Një vlerësim i tillë është kryer dhe për programin e studimit “Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik”

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Format e organizimit të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe punime të parashikuara në programin mësimor, sipas rregullores së këtij programi studimi.

Sipas të dhënave të planit mësimor, syllabuseve dhe takimit me stafin dhe studentët, mësimdhënia realizohet kryesisht me leksione.

o Seminarët zhvillohen rregullisht dhe në përputhje me planin mësimor.

o Ushtrimet janë pjesë e rregullt e detyrave të kursit.

o Laboratori është i aplikueshëm për këtë program studimi.

o Praktikë lëndore: **Nuk ka**

o Praktikë profesionale: *Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale të përshtatshme dhe në funksion të programit të studimit*

#### Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i dijeve të studentëve bëhej në bazë të pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në seminare, realizimin e projekteve/detyrave të kursit, testimeve gjatë vitit dhe provimit përfundimtar. Format e kontrolli i njohurive të studentëve janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Nga takimet e realizura dhe bazuar në RVB, rezulton se nuk ka aktivizim të studentëve në kërkimet shkencore dhe projektet e implementuara nga departamenti duke patur në konsideratë edhe kohën e shkurtër të aktivizimit të programit.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik”, pranë KU “Luarasi”, realizohet në përputhje me Ligjit nr. 80/2015, Udhëzimin Nr. 18, datë 17.08.2017 të MASR dhe Rregulloren e KU “Luarasi”, si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik”.

Përgjithësisht, nota mesatare e studentëve në hyrje është mbi 8 dhe në përfundim të një viti tentohet të ruhet kjo mesatare, ndërkohë që nga viti në vit mesatarja në dalje ka tendenca në rritje. Referuar shifrave më shumë se 50% e studentëve kanë mbaruar studimet në këtë program studimi brenda afateve normale të përcaktuara për këtë cikël studimesh (2 semestra). Kalueshmëria e studentëve gjatë vitit akademik 2017-2018 është 100% deri në diplomim.

Nga takimet me studentët u vu re se ata ishin të mirë-informuar mbi kohë-zgjatjen e studimeve, praktikat profesionale që mund të bënin, procedurat e diplomimit e kështu me rradhë.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve**

Në këtë program studimi pranohen për t’u regjistruar shtetas shqiptarë dhe të huaj, që zotërojnë :

- a. dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme
- b. një diplomë të studimeve të ciklit të parë, “Bachelor” së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MAS, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e sipërmendura.
- c. dëshmi të gjuhës angleze ose japin provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.
- d. Tarifa e shkollimit.

e. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a) Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b) Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Konstatohet se nota mesatare e studentëve për programin master professional në hyrje është brenda kriterëve. Referuar shifrave, më shumë se 50% e studentëve kanë mbaruar studimet në këtë program studimi brenda afateve normale të përcaktuara për këtë cikël studimesh (2 semestra). Kalueshmëria e studentëve gjatë vitit akademik 2017-2018 është 100% deri në diplomim. Grupi I KVJ konstaton se Kolegji prezanton statistika dhe i raporton rregullisht në MASR sipas udhëzimeve. (Evidenca Nr. 27 – Raporti Vjetor 2017-2018)

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela ne Aneks)**

Nota mesatare e studentëve në hyrje është 7.7. dhe në përfundim të një viti tentohet të ruhet kjo mesatare, ndërkohë që nga viti në vit mesatarja në dalje ka tendenca në rritje duke arritur në 8.93. Referuar shifrave më shumë se 50% ose 9 nga 16 studentë kanë mbaruar studimet në këtë program studimi brenda afateve normale të përcaktuara për këtë cikël studimesh (2 semestra). Kalueshmëria e studentëve gjatë vitit akademik 2017-2018 është 100% deri në diplomim.

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare.**

Studentët e diplomuar në fund të vitit (programi ka filluar në vitin 2017) janë 9 nga 16 studentë dhe nota mesatare vlerësohet në 8.92.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.**

Konstatohet se në KU “Luarasi” pranohen për të ndjekur studimet universitare, edhe studentët që vërtetojnë me dokumente zyrtare, konform legjislacionit në fuqi, transferimin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë publik ose privat. Për studentët që dëshirojnë të transferojnë studimet e tyre pranë KU “Luarasi”, institucioni ka ndërtuar strukturën e pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit përmes Komisionit të Ekuivalentimit të programeve mësimore. Ky proces i lejon studentët të mbartin lëndët e paekuivalentuara për t’i shlyer ato në vijimësi të studimeve të tyre.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 9 studentë ndërsa numri total i të punësuarve jo përputhje me diplomën është 7 studentë

**Numri total të diplomuarve**

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 9 studentë.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 9

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Standardi/Kriteret
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program Masteri zotërojnë minimalisht diplomën Bachelor dhe kanë siguruar të paktën 180 ECTS</p> <p>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve për këte program studimi bëhet në përputhje me udhëzimet e MASR, rregullonen e IAL dhe ato të programit të studimit.</p> <p>Pranimi i studentëve në “Master Profesional”, bëhet edhe nepermjet aplikimit të kriterëve të vecanta të përcaktuara në Rregulloren e Programit Master Profesional për pjesën e kushteve specifike të pranimi të studentëve. Në përfundim të këtij cikli, siç parashihet në Rregulloret, studentet nuk diplomohen në rast se nuk kanë paraqitur dokumentin e mbrojtjes së gjuhës angleze sipas kriterit ligjor. Për programet Master Profesional niveli i gjuhës angleze është B1</p> <p>Studentet që kanë ndjekur këte program studimi siç konstatoam nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mesimore dhe pranuar konform ligjit dhe të rregulloreve në fuqi dhe ata që nuk kanë mbrojtur gjuhën e huaj nuk janë diplomuar. Institucioni vlerëson në mënyrë periodike ecurinë e studentëve, duke propozuar edhe përmirësimin e kriterëve të pranimi. Kjo detyrë realizohet kryesisht nga njesia baze për programin.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion një informacion i nevojshme për mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve, si dhe të dhëna nga sistemi alumni dhe për punësimin e studentëve të tij.</p> <p>Institucioni mban lidhje ngushta me organizma publike dhe private të cilat ofrojnë oportunitete për punësim të dhe shkëmben informacion me to.</p> <p>KU “Luarasi”, për gatit për studentet informacion të perhershëm mbi proceset e licensimit dhe të akreditimit të institucionit në teresi por edhe të programeve të studimit të Ciklit Master Profesional, për vlefshmërinë e diplomës. Informacioni përcillet nepermjet platformes elektronike, broshurave apo edhe të dokumentave të tjera që pasqyrojnë</p>

	<p>performancen reale te institucionit.</p> <p>Ne kete institucion funksionon Zyra e Studentit dhe e Keshillimit te Karrieres e cila i ndihmon dhe orienton nga afer studentet ne perzgjedhjen e profilit te ngushte profesional ne vazhdimin e studimeve ne sistemin e kualifikimit pasuniversitar.</p> <p>Zyra e keshillimit karrieres ka krijuar databazen e srudenteve dhe realizon programin e saj nepermjet komunikimeve individuale ose ne grup te studenteve per ti orientuar per punesim. Ajo organizon takime me personalitete te shkences, arsimit, biznesit, drejtesise.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentet mbështetëse, konstatohet se KU “Luarasi” mban statistika të plota vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë që ai ofron dhe raporton rregullisht ne MAS sipas udhëzimeve dhe afateve te caktuara nga organi ekzekutiv.</p> <p>KU “Luarasi” dergon ne MAS statistika per numrin e studenteve te diplomuar per secilin vit akademik. Keto te dhena mbahen ne rregjistrin baze te studenteve sipas fakultetit dhe programeve te studimit.</p> <p>KU “Luarasi” ka te dokumentuar dhe ne forme elektronike database per ecurine e studenteve te programit “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik”, me te dhenat e pranimi deri ne diplomimin e tyre. Ne rregjistrin baze jane hedhur notat e studenteve per secilen lende te programit studimor.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Sekretaria mesmore e KU “Luarasi” ka te dhena per studentet e punesuar qe kane perfunduar Masterin Profesional ne “Sigurine dhe Rending Publik”.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>	<p>Studentet informohen prane sekretatise mesimore per programet e studimeve nga ana e pergjegjesit te programit, per rezultatet e vleresimit te ketij programi, kohezgjatjen e ketij programi etj. Te intersuarit informohen per programin e studimit</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>ne faqen e institucionit ne internet si dhe me broshura informuese rreth programit të studimit.</p>
<p><b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Ne institucionin “Luarasi” ne qender te vemendjes eshte mbeshtetja e studenteve per te arritur rezultate sa me te mira gjate viteve te studimit.</p> <p>Studentët e këtij cikli studimi mbështeten gjatë gjithë procesit të formimit akademik nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>KU “Luarasi” ndihmon në sitemimin e studentëve dhe njëherësh në orientimin e praktikës, duke adresuar, sipas specifikave, realizmin e një produkti teorik - aplikativ nga secili student.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Konstatojme se pranimi i studenteve është realizuar ne zbatim te ligjislacionit te arsimit te larte te RSH mbeshtetur ne Statutin dhe Rregulloren e institucionit si dhe rregulloret e programeve te studimit.</p> <p>Studentet informohen ne lidhje me programet e studimit, sulabuset e lendeve, te drejtat dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Zyra e Studentit dhe e Keshillimit te ndihmon dhe orienton nga afer studentet ne perzgjedhjen e profilit te ngushte profesional ne vazhdimin e studimeve ne sistemin e kualifikimit pasuniversitar.</p> <p>Institucioni mban dhe ruan te dhena statistikore per numurin e studenteve te regjistruar ne programin Master Profesional.</p>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Gjatë procedurës së vlerësimit konstotohet se kërkimi shkencor në KU “Luarasi” zhvillohet në tre nivele: Në nivel departamenti, i cili bëhet iniciator i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore, në nivel institucioni duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme me të cilat ndan të njëjtat vlera dhe synime, si edhe punë kërkimore individuale e pedagogëve të KU “Luarasi”. KU “Luarasi” ka të punësuar personel akademik të kualifikuar, me tituj akademik dhe grada shkencore, si dhe me eksperiencë nëaktivitet shkencor (autorë tekstesh, monografish, artikuj shkencorë, etj.), në fushën ku orientohet programi i studimit

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor



Bazuar ne RVB dhe në takimet e realizuar, konstatojmë sen institucion veprojnë disa qendra që organizojnë, koordinojnë dhe realizojnë kërkimin shkencor në funksion të programit të studimit dhe më gjerë. Qendra FAB (Kërkimi Shkencor, Projektet dhe Inovacioni) bashkëpunon përkundrejt të gjitha projekteve në fusha të ndryshme atë të Drejtësisë, Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, Kërkimit Shkencor dhe Invoacionit me stafin e pedagogëve dhe studentëve të Kolegjit Universitar “Luarasi”.

Sipas RVB dhe takimeve të realizuar kërkimi shkencor në KU “Luarasi” zhvillohet në tre nivele: Në nivel departamenti, i cili bëhet iniciator i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore, në nivel institucioni duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme me të cilat ndan të njëjtat vlera dhe synime, si edhe punë kërkimore individuale e pedagogëve të KU “Luarasi”.

**Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

Sipas RVB Botime nga personel akademik i Departamentit të së Drejtës Penale, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Rendi dhe Siguria Publike” në revista shkencore shkon në rreth 22 (njëzet e dy).

**Numri i projekteve kërkimore të fituara**

Sipas RVB Fakulteti i Drejtësisë KU “Luarasi” prej një viti ka fituar një projekt me OFSA dhe në partnership ka ngritur Klinikë Ligjore “Luarasi”.

**Numri i projekteve të zbatuara**

Sipas RVB Fakulteti i Drejtësisë KU “Luarasi” prej një viti ka fituar një projekt me OFSA dhe në partnership ka ngritur Klinikë Ligjore “Luarasi”.

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Sipas RVB janë rreth 8(tetë) aktivitete të organizuara në periudhën nëntor 2017 – Maj 2018. Aktivitetet janë zhvilluar në trajtën e tryezave, seminareve, konferencave shkencore.

**Numri i Çmimeve Kombëtare**

Paraqitet 1 (një) cmim i fituar në konkurs ndërkombëtar i cili është fituar 19 Nëntor 2016, Konkurs ndërkombëtar i iniciuar nga Youth Development Group, në të cilin ekipi përfaqësues i Luarasit u shpall fitues.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i KU “Luarasi” kontribuon në veprimtarine shkencore si autore tekstesh mesimore, monografish shkencore dhe janë pjesemares në aktivitete shkencore brenda dhe jashte vendit.</p> <p>Institucioni “Luarasi” publikon revisten periodike ‘Mendimi’ qe permban shkrime shkencore te pedagogeve dhe specialisteve sipas fushes. Nje pjese e mire e stafit akademik ka botuar studime dhe artikuj shkencore ne reviste njohura ne fushen e shkences si “Tribuna</p>

	Juridike”, “Avokatia”, “Studime historike” etj. Ne keto botime pasqyrohet rritja e nivelit te pergatitjes profesionale dhe perfshihen ne bibliografine e disipline qe mbulon pedagogu.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mesimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mesimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mesimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mesimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	KU “Luarasi” nuk ofron programe studimi ne gjuhe te huaj.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mesimorshkencor;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mesimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Konstatuam se ne KU “Luarasi” organizohen trajnime dhe hartohen programe kualifikimi me trupen akademike per perditësimin e metodave dhe teknologjive te reja ne mesimdhënie, perfshirjen ne programet studimore te disiplinave te reja, te informacionit te ri. Ne keto veprimtari kane lektuar, pedagogje me kohe te plote por edhe specialiste te huaj.  Institucioni “Luarasi” ka mbeshtetur nje numur pedagogesh per kualifikime jashte vendit dhe pjesemarije ne veprimtari shkencore ne vende te ndryshme.
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;  <b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Ne institucion ka nje baze te dhenash te studimeve shkencore te realizuara nga pedagoget pjesetare te programit te studimit “Master Profesional” ne “Siguria dhe Rendi Publik”.  Institucioni disponon nje database te plote te dhenash per veprimtarine botuese te stafit akademik, ku evidentohen botime me karakter shkencor, studime, tekste dhe monografi, pjesemarije ne veprimtari me karakter shkencor brenda dhe jashte vendit.  Veprimtaria shkencore e stafit akademik pasqyrohet ne raportin vjetor te veprimtarise akademike dhe depozitohet ne dosjen personale te pedagogjeve.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
Ne KU “Luarasi” zhvillon veprimtarine studimore shkencore si ne rrafshin institucional ashtu dhe ate individual. Personeli akademik mer pjese ne aktivitete shkencore te organizuara nga institucioni, por edhe nga institucione omologe ne brenda dhe jashte vendit.  Ne revisten periodike “Mendimi” organ i ketij institucioni botohen nje pjese e kontributeve shkencore te stafit akademik. Personeli akademik eshte perfshire ne nje proces kualifikimi shkencor individual dhe institucional te	



vazhdueshem.

KU "Luarasi" disponon dokumentacion te rregullt per veprimtarine kerkimore shkencore, botuese per pedagoge dhe ky sherben edhe si nje tregues per vlersimin e profesionalitetit te shkencor te tyre.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka realizuar bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, duke reflektuar në aktivitete kurrikulare dhe ekstra - kurrikulare, si trajnime për studentët dhe personelin akademik, leksione të hapura, seminare, etj. Vecanërisht vitin e fundit, si rrjedhojë e zgjerimit të institucionit me Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe disa programe të reja studimi. Në këtë kontekst vlen për t'u theksuar vecanërisht fakti që në maj Kolegji Universitar "Luarasi" është bërë pjesë e rrjetit UNIADRION (Adriatic Ionian Network for Universities, Regions, Chamber of Commerce and Cities), për të bashkëpunuar në Projektet Globale të Kërkimit Shkencor, Projekte në fushat e Jurisprudencës, Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. "Luarasi" gjatë vitit akademik 2017-2018 ka nënshkruar një marrëveshje me një ndër universitetet më të rëndësishme në Itali.

Gjithashtu Kolegji Universitar "Luarasi" ka nënshkruar apo është në proces nënshkrimi të marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa institucione e organizata qe operojnë në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Në radhën e marrëveshjeve të nënshkruara për bashkëpunim me institucione te tjera janë:

- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU "Luarasi" dhe Drejtorisë së Burgjeve
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU "Luarasi" dhe Akademisë së Sigurisë
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU "Luarasi" dhe Policisë Bashkiake
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU "Luarasi" dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU "Luarasi" dhe Shoqatës Shqiptare Alumni "George C. Marshall", etj.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare është - **4 persona të inkuadruar në Projektin "Klinika Ligjore Luarasi"**.
- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit është - **2 pjesëmarrës nga KU "Luarasi" në UNIADRION**
- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor : Qendra FAB; Laboratori i Kriminalistikës; Laboratori i Informatikës; Klinika Ligjore, Auditorët, Biblioteka; Salla leximi; Televizioni News 24; Revista Psikologjia, Gazeta Panorama; Gazeta Shqiptare; Ballkan Eëb

- ☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë
  - Institucionet qeveritare bashkepunuese
  - Organizatat Profesionale
  - Komuniteti i biznesit, tregu i punes

Komunikimi dhe bashkëpunimi paraqitet si më poshtë:

- Akademia e Sigurisë: Në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbim pedagogesh, konferenca etj
- Policia Bashkiake: Shkëmbim ekspertesh, praktika mesimore etj
- Shoqata e Avokatëve Penaliste : Shkëmbim ekspertesh, praktika mesimore etj
- Shoqatën Shqiptare Alumni “George C. Marshall”: Orë mësimore dhe seminareve me lektorë të huaj
- Hysenbelliu Grup : praktika mësimore, internshipe

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Per realizimin e programit te studimit “Siguria dhe Rendi Publik”, Kolegji Universitar “Luarasi” ka bashkëpunuar me institucionet e arsimit të lartë në fushën e sigurisë dhe rendit publik si dhe më institucione të tjera brenda e jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu Kolegji Universitar “Luarasi” ka nënshkruar apo është në proces nënshkrimi të marrëveshjeve të bashkëpunimit më disa institucione e organizata qe operojnë në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë si:</p> <p>- Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU “Luarasi” dhe Akademisë së Sigurisë</p> <p>KU “Luarasi” dhe Policisë Bashkiake - Marrëveshje Bashkëpunimi midis KU “Luarasi” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë - Shoqatën Shqiptare Alumni “George C. Marshall” etj.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi” mban lidhje te ngushta me biznesin dhe tregun e punës. Konstatuam se nje pjese e studenteve kane ardhur nga institucionet e rendit dhe te shërbimeve dhe praktika te tilla jane prezente</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së</p>	<p>Ne kete institucion konstatuam nje bashkepunim te ngushte midis organizmave mesimore si dekanat departamente por edhe ndermjet vet personelit, nje fryme pozitive kolegjaliteti dhe bashkepunimi ne interes te forcimit te komponentit te cilesise ne pergatitjen e studenteve.</p>

<p>përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Brenda institucionit ka nje atmosfere pozitive pune dhe fryme kolegjaliteti qe eshte rrjedhoje e ne nje ndarje te qarte te perjegjesive dhe roleve te gjithesecilit anetar te trupes akademike ne sistemin e mesimdhenies dhe kontrollit te cilesise se dijeve</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marredhenie bashkepunimi me institucionet homologe jashte vendit dhe aktoret e biznesit vendas ose te huaj.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;  <b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;  <b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se Institucioni “Luarasi” ka vendosur marredhenie te ngushta bashkepunimi me institucione homologe brenda dhe jashte vendit mbi bazen e marreveshjeve dypaleshe bashkepunimi, memorandumeve, protokolleve.  Institucioni zhvillon marredhenie partneriteti me organizma dhe organizata te biznesit vendas dhe te huaj per kryerjen e praktikave profesionale dhe partnershipit.  Me keto institucione, SHLUJ “Luarasi” ka organizuar veprimtari te ndryshme si Eëork-shope, kurse trajnimi, me qellim te forcimit te ketyre lidhjeve ne dobi te pergatitjes profesionale te studenteve.  Institucioni” Luarasi” harton nje raport analitik mbi keto marredhenie bashkepunimi, pare ato ne funksion te realizimit te objektivave dhe misionit te tij</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Konstatojme se Institucioni SHLUJ Luarasi ka vendosur dhe zhvillon marredhenie te ngushta me institucione homologe brenda dhe jashte vendit.</p> <p>Institucioni në bashkëpunim me institucionet homologe, realizon dhe zhvillon konferenca seminare, simpoziume shkencore, trajnime te perbashketa te personelit akademik, leksione te hapura me personalitete te shkences vendas e te huaj etj.</p>	



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### **a. Pika te forta:**

1. Programi i studimit Master Profesional ne “Siguria dhe Rendi Publik ” nje kombinim harmonik midis pergatitjes teorike dhe asaj praktike te studenteve, midis informimit dhe formimit te tyre, midis leksioneve ne auditor dhe kerkimit ne laborator, teorise dhe praktikes.
2. Staf i akademik i angazhuar ne kete program studimi perbehet nga personalitete te shquara te fushes se drejtesise dhe me ekspertize te larte profesionale.
3. Cilesia e disiplinave shkencore ne kete program studimi eshte ne perputhje me zhvillimet me te fundit ne keto shkenca dhe pasurohet me aparat te ri konceptual.
4. Personeli akademik eshte i angazhuar me kapacitet te plote ne proceset e mesimdhënies por edhe te formimit teoriko-praktik te studenteve ne profile te reja specialistesh te rendit dhe sigurise kombetare.
5. KU "Luarasi" ka marrëveshje të gjera bashkëpunimi me rrjetin e institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, për të shkëmbyer me ta përvojat dhe informacionin, organizimin e aktiviteteve shkencore dhe praktikave.

### **b. Pika te dobëta:**

1. Staf i akademik nuk mbulon në masën 70% ngarkesën mësimore ashtu sikurse e kërkon Ligji 80/2015.
2. Literatura e specialitetit në gjuhën shqipe nuk është e pasur.
3. Përfshirja e stafit akademik ne shume detyra administrative.

### **c. Mundësite:**

- 1) Programi i ri Master Profesional ne “Siguria dhe Rendi Publik” krijon mundësi te reja per punesim per studentet qe kane perfunduar me sukses studimet.
- 2) Përvoja e fituar gjate zbatimit te programit Master Profesional mund te shërbeje si mundësi shkëmbimi eksperience edhe per institucione te tjera publike e private qe pergatisin specialiste te ketyre profileve.
- 3) Pajisja laboratoreve me mjete dhe teknika me te reja ne funksion te programit të studimit.

### **d. Pengesat:**

1. Numur i kufizuar i studenteve pjesemarrës ne kete program shpjegohet me kerkesen ende te ulet per kualifikime speciale ne programe Master Profesionale ne sektoret e sigurise dhe te rendit publik
2. Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të larte.
3. Ne sistemin e karrieres se specialisteve te ketyre sektoreve nuk aplikohen sisteme te vleresimit sipas shkalleve te kualifikimit per ngritjen ne karriere.

4. Ngarkesa e punës per punonjësit e strukturave të sigurisë e vështirëson ndjekjen e studimeve të nivelit të dytë master profesional.

## **SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION ACCORDING TO THE SWOT METHOD.**

### **a. Strengths:**

1. Professional Master's degree program in "Public Safety and Order" is a harmonious combination between theoretical and practical preparation of students, between their information and training, between lectures at the auditorium and laboratory research, theory and practice.
2. The academic staff involved in this study program is composed by distinguished personalities in the field of justice and with high professional expertise.
3. The quality of scientific disciplines in this study program is in accordance with the latest developments in these sciences and is enriched with new concepts.
4. The academic staff is engaged on full capacity in the teaching process but also in the theoretical – practical education of the students with new profile of national security specialty.
5. KU "Luarasi" has wide collaboration agreements with homologous institution network inside and abroad and exchange with them the experiences and information, also organizing scientific activities and internships.

### **b. Weaknesses:**

1. The academic staff does not cover 70% of the teaching load as required by Law 80/2015.
2. The literature of subject specialty in Albanian language is not rich.
3. Involvement of academic staff in many administrative tasks.

### **c. Opportunities:**

1. The study program Professional Master in Security and public order, provides new employing opportunity for the students, successfully graduated.
2. The experience gained during the implementation of the study program might serve as a opportunity for experience exchange even for other public and private institutions who prepares specialists on this profiles.
3. Equip of labs with the latest tools and techniques in function of the study program.



**d. Threats:**

1. The low number of enrolled students in this study program is justified with the still low request for qualification in Professional Master in the sector of Security and public order.
2. Continuous change of the legal and sub-legal acts of higher education.
3. In the career system of the specialist in this sector does not applied evaluation system in accordance with the qualification scheme for rising up in career.
4. The overload of labor for the employers in the security structures makes it difficult to follow the studies in the second level master.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof. Dr. Kristaq Xharo**

**Dr. Marjana Çadri**